



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. Prot. _____

Tiranë ____/____/2026

VENDIM

Nr. 7, datë 19.03.2026

PËR
DHËNIEN E VËRTETIMIT PËR PLOTËSIMIN
E KËRKESAVE LIGJORE DHE NËNLIGJORE
LIDHUR ME SIGURIMIN E DEPOZITAVE BANKËS JET SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 17, të nenit 19, të nenit 21, të nenit 22, të nenit 25, të nenit 26, pika 3, të nenit 52 pika 1, shkronja “p” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 20, pika 1, shkronja “f”, të nenit 22 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 5, të nenit 6 të udhëzimit nr. 3241, datë 18.12.2014 “Për sigurimin e Depozitave në banka”, i ndryshuar, të nenit 7, pika 4, të nenit 9, pika 3 të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 6/1, shkronja “e” të Rregullores nr. 20, datë 25.09.2017 “Për nënshkrimet e autorizuar në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 31 datë 10.10.2025 “Për caktimin e Z. Martin Blushi, zëvendës drejtor i përgjithshëm, për të ushtruar kompetencat për mbarrëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, deri në emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm”, të nenit 18 pika 2 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014, si dhe me propozim të Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Dhënie e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave Bankës “Jet SH.A.”.
2. Autorizohet Zëvendës drejtori i Përgjithshëm për nënshkrimin dhe dorëzimin e vërtetimit Bankës “Jet SH.A.”.
3. Ngarkohet Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për dërgimin e këtij vendimi pranë Autoritetit Mbikëqyrës.



AGJENCIA
E SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE

Agjencia e Sigurimit të Depozitave
Rruga e Elhanit, Nr. 317
Tiranë / Albania
t: +355 (4) 2362 989 / 2347 298 f: +355 (4) 2362 984
e: info@asd.gov.al w: www.asd.gov.al



4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Donald Duraj

Kryetar

Shqipe Malaj

Sekretare

